



## ZGJATJE E AFATIT PËR DORËZIM TË KËRKESAVE TË TVSH-04 DHE PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT E-TAP

Drejtoria e të hyrave publike njofton tatimpaguesit dhe përdoruesit e shërbimeve elektronike të sistemit e-**Tatim personal** se është duke e përmirësuar sistemin e-TAP. Prandaj, sistemi e-TAP do të ndërpritet duke filluar nga data 26.01.2024 (e premte) në ora 16:00. Ndërhyrja do të kryhet gjatë fundjavës së ardhshme dhe pas përfundimit të aktiviteteve, DHP do të informojë menjëherë.

Njoftojmë publikun se për shkak të këtij procesi të përmirësimit të sistemit, janë të mundshme edhe ndërprerje në funksionimin e aplikacionit **TVSH-ja ime**. Kërkojmë nga tatimpaguesit dhe përdoruesit e shërbimeve të DHP-së që të jenë të kuptueshëm ndërkohë që përditësimi i sistemit është në vazhdim, pasi ai do të mundësojë shërbime më cilësore për përdoruesit e fundit.

Për shkak të kryerjes të këtij përmirësimi dhe vështirësisë në dorëzimin e deklaratave tatimore përmes sistemit e-**Tatimet**, afati për dorëzimin e deklaratave të TVSH-04 vazhdon deri të hënën, 29.01.2024.